



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	ARPL
Nr. Prot. Broj.Prot. Prot.No	420-2/26
Nr. ffaqeve Broj.stranica No.pages	-09-
Data. Datum. Date.	17.07.2026
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit Dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	17.07.2026
REFERENC-Ë:	420/26 - ARPL
PËR/ZA/TO:	„ISEFERI” Sh.p.k Adresa: Zona Industriale , Shiroke, Komuna Suharekë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Bajram KAFEXHOLLI , U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së, <i>Per</i> Z. Zymer MRASORI, U.D. Drejtor i ARPL-së/MMPH
NGA/OD/FROM:	Myrvete Mulaj, Zyrtare e Lartë për Leje Ujore dhe Shfrytëzim të Ujit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Vazhdim të Lejes Ujore me nr.53/21-ZSP, dt.11.02.2021,

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 420/26 dt. 29.01.2026, për vazhdim të Lejes Ujore me nr. 53/21-ZSP-2021, dt. 11.02.2021 për shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga pusi për prodhimin e betonit “ISEFERI” shpk, Suharekë dhe ka vendosur si në Vendimin për vazhdimin e Lejes Ujore, pas plotësimit të dokumentacionit, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. V.LU.1

Datë: 17/07/2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „ISEFERI” SH.P.K., Komuna Suharekë, me Nr. prot. 420/26, për vazhdimin **LEJES UJORE**, për shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga Pusi 2 për prodhimin e elementeve të betonit, betonit të freskët dhe për nevojat e gurëthyesit, në piken me koordinatat, $X = 7\,483\,299.510$ dhe $Y = 4\,689\,565.678$ sipas lejes paraprake, në sasi prej $Q_{maxP2}=3.47$ l/s, sipas kushteve vijuese:

1. Vazhdimi i Lejes Ujore i referohet ekskluzivisht shfrytëzimit të ujit nga pusi për prodhimin e elementeve të betonit, betonit të freskët dhe për nevojat e gurëthyesit “ISEFERI” SH.P.K., Suharekë.
2. Vazhdimi i Lejes Ujore lëshohet në bazë të plotesimit të kushteve të dokumentacionit të Lejes Ujore paraprake për kompleksin e objekteve nën kushtet vijuese:



3. Afati i vazhdimit të lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
4. Pala është e obliguar që për sasinë e ujit që shfrytëzon për kohën që operon duhet të raportoj në ARPL-MMPH dhe të kryej Obligimin financiar të caktuar sipas UA në fuqi për Struktura e Pagesave të ujit;
5. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujore nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujore;
6. Për vazhdimin e Lejes Ujore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujore;
7. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartecaktuara në afatet e parapara kohore.

Arsyetim

Zyrtari përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për vazhdim të Lejes Ujore shfrytëzimit të ujit nga pusi P₂ për prodhimin e elementeve të betonit, betonit të freskët dhe për nevojat e gurëthyesit "ISEFERI" SH.P.K., Suharekë, në piken me koordinatat sipas lejes paraprake, vlen të theksohet se Pusi P₁ është shembur vetvetiu dth. është mbyllur dhe nuk është në funksion për shfrytëzim:

- Kopja e Vendimit të Lejes Ujore me nr. pr. 53-2/21-ZSP-260 të datës 11.02.2021,
- Fatura e pagesës për LU.
- Pagesa sipas Vendimit Financiar me nr. pr.53-2/21, dt.02.04.2026,
- Foto e ujëmatësit.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr: 420/26 - ZSP- 2026, Datë: 17.07.2026

Prishtinë

T'i dërgohet :

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së
- Inspektoratit të MMPH-së
- Komunës Suharekë;
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së



U.D. Bajram KAFEXHOLLI